



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : *Banorët e Nj. Administrative Ana Malit.*

Data : 06 .10.2022

Ora : 13.00

Vendi: *Shkolla e Oblikës*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 28, nga të cilat 2 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Per draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Drejtues dhe specialist të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetari i bashkisë dhe Kryetarja e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet që konsultohen janë si vijon:

Hapja konsultimit nga Kryetari i Bashkisë, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

Z. Arben Ceni Administrator i Njësisë Ana Malit: prezantim për tematikat dhe diskutimet.

Kryetari i Bashkisë : - Falenderon për pritjen duke e konsideruar shumë të rëndësishme këtë formë konsultimesh dhe marrjen direkte nga qytetarët për problematikat që shqetësojnë zonat e ndryshme. Kjo është mënyra më e mirë për të bërë një planifikim sa më të mirë të problematikave dhe investimeve afatmesme dhe afatgjata. Kjo është më tepër rëndësi sepse investimet janë për ju dhe në shërbim tuajin.

E gëzon pjesëmarrja dhe angazhimi për çështjet e komunitetit dhe territorit ku banojnë dhe konstatojnë se gjatë dëgjësive që janë zhvilluar vite me parë, sot i kemi të zgjidhura dhe diskutojmë problematika më të vogla dhe më të realizueshme. Normalisht ekzistojnë limitet financiare që nuk mjaftojnë por është me rëndësi që mes këtyre dëgjësive të bëjmë ndërhyrjet më prioritare. Ai i lë fjalën edhe kryetares së këshillit bashkiak znj. Brisela Kadia.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadia : - Falenderon për pjesëmarrjen, duke shtuar se është i disati vit që i organizohen këto dëgjësia për të për të marrë nga ju nevojat dhe kërkesat direkte. Është me rëndësi që të kemi takime më të shpeshta që të japim shërbime për ju përmes takimit dhe zgjidhjes së problematikave tuaja.

Kemi marrë një sërë sygjerimesh nga ana e juaj vitin e kaluar, normalisht nevojat janë të mëdha dhe jemi përpjekur që me këshillin dhe bashkinë të vendosim se cilat janë investimet më të rëndësishme, ajo shpreston që të kenë realizuar një pjesë të pritshmërive tyre nga viti i kaluar dhe shpresojnë që këtë vit të arrijnë të marrin sërish sugjerime të cilat do të mund t'i zbatojnë.

Zv. Kryetari i Bashkisë: - Shpreston që të kenë një bashkëbisedim sa më konkret sa i përket investimeve për 2023 dhe për PBA 2023-2025. Sipas një agjende të planifikuar, që orienton për temat dhe funksionet do zhvillohet edhe bashkëbisedimi por gjithësi diskutimi është i hapur.

I: ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZË, I MESËM I PËRGJITHSHËM, PROFESIONAL

Të gjithë duan që të investohet në të gjitha ato që ju propozoni por mundësitë na detyrojnë të fokusohemi në ato që janë më imediate dhe më të realizueshme.

Skender Taipi: Kopshti Oblike: - Kemi 25 nxënës dhe mungon pastruesja. E kemi ngritur si problem por kjo akoma nuk është zgjidhur, kjo është një kërkesë e komunitetit dhe duhet të kemi një zgjidhje.

Ka dy vite që jemi me të njëjtin problem por duhet zgjidhur se është një infrastrukturë e mirë dhe nuk duhet të lihet pas dore vetëm sa i përket pastrimit.

Për shkollën jemi në rregull, kemi bazën materiale të ngrohjes, janë bërë edhe lysterjet e ambienteve.

ZV. kryetari i Bashkisë : - Problemi qëndron në faktin se fondi për këtë pjesë është fond i deleguar dhe ne akoma nuk kemi marrë një zgjidhje.

Z. Admir Shullani, Shkolla e Oblikës: - Kemi nevojë që të kemi një vendosje të emrit të shkollës, kërkojmë realizimin e një ceremonie për këtë qëllim. Kemi nevojë imediate lyrerjen e tre klasave brenda mundësive.

II Menaxhimi dhe pastrimi i mbetjeve.

Bardhok Doda , Muriqan: - Problem mbeten koshat e plehrave sidomos tek dogana ka shumë nevojë që të kemi një vëmendje të shtuar pse jo edhe tre here në ditë sepse ka një fluks shumë të madh. Ka mbetje jashtë dhe ka shumë ndotje.

ZV. kryetari i bashkisë : -Në një farë formë ne ja kemi dalë sepse më së fundmi është futur shërbimi në këtë zonë dhe duke qënë se është ky problem duhet që sidomos gjatë verës të kemi një vëmendje më të shtuar për këtë pjesë.

Bardhok Doda, Muriqan: - Në verë ne kemi edhe shumë emigrantë që kthehen dhe shtohet popullsia, ne paguajmë për këtë shërbim, edhe ndriçimi duhet parë sepse jemi shumë pak që paguajmë.

Kryetari i Bashkisë : - Të shtohet frekuenca e pastrimit në verë dhe në periudha të caktuara të vitit, sidomos gjatë gushtit. Ne e dimë këtë problematike dhe gjatë kësaj periudhe kemi riorganizuar frekuencat si në qytetet ashtu edhe në njësi , është me tepër rëndësi kjo që thoni ju dhe do të kemi një vëmendje të shtuar për këtë problematikë që paraqisni.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak zj.Brisela Kadia: - A janë shtuar koshat në njësinë Ana e Malit?

Z. Arben Ceni Administrator i Njësisë Ana Malit: - Koshat janë shtuar, por edhe në rrugët e reja kemi nevojë të kemi frekuencë të shtuar.

Kryetari i Bashkisë: - Qëllimi është pikërisht kjo sepse shohim dhe dëgjojmë problematikat në çdo takim, po kërkohet frekuenca dhe shtimi i saj dhe duhet të kemi një vëmendje ndaj kërkesave të banorëve.

Gjithashtu edhe sa i përket firmës kontraktuese duhet të ketë vëmendje sa i përket pastrimit deri në fund dhe të mos lihen pas.

III. Menaxhimi i ujitjes dhe shërbimet bujqësore.

Z.Alban Sekja Drejtor Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe AMTP-ve : Bashkia i ka të caktuara kompetencat në fushën e bujqësisë, ne kemi kanale të dyta dhe të treta për sa i përket ujitjes dhe kullimit. Është qeveria ajo që merret me pronat dhe me subvencionet.

Qytetari: - Me kanalet kulluese jemi të kënaqur.

Z.Alban Sekja:- E vetmja zonë me ujitje mekanike është Ana e Malit dhe kjo është ajo që Bashkia ka në dorë dhe funksion. Ne nuk japim subvencion dhe sa i përket kërkesave që kemi ne përgjigjemi si dhe asistojmë sa kemi mundësi.

Kryetari i Bashkisë : - Zotëria ka shqetesim për sa i përket vaditjes, ne kemi zhvilluar një takim me Ministren e Bujqësisë për sa i përket kanaleve vaditëse ku kemi kërkuar vëmendje të shtuar edhe ministria u ndërgjegjësua që për vitin tjetër të kemi një prioritet më të madh për Shkodrën.Kemi marrë një angazhim për 2023 sa i përket zonës se Nënshkodrës , janë investime që nuk mund të përballohen nga bashkia sepse janë me vlera shumë të mëdha ,shpresojmë që vitin tjetër të kemi mundësi për ta rregulluar këtë situatë.

Fatmir Meti, Banor : - Kemi vite që diskutojmë për këtë çështje dhe është krejt e drejtë që të ketë një sistem vaditës , a ka bashkia ka një projekt të gatshëm për këtë situatë ?

Kemi nevojë që të kemi edhe një investim në lagjen Zenelaj për një rrugë të shkrutër. Gjithashtu edhe lagjja Telukej një rrugë prej 250 m.

Z.Alban Sekja Drejtor Drejtorja e Bujqësisë,Zhvillimit Rural dhe AMTP-ve : - Zona ka një specifikë tjetër, duke qënë se është mekanik rrjeti vaditës dhe tanimë jemi duke ndryshuar këtë situatë. Ne kemi projekte dhe duhet gjetur forma e financimit.

Kryetari i Bashkisë : - Është një shprehje me të cilën jam përballur gjatë kësaj periudhe dhe për hir të vërtetës Bashkia është në vendin e parë sa i përket projekteve dhe cilësisë së hartimit të tyre, në rastin konkret kam pasur 15 projekte të gatshme zbatimi të cilat nuk janë financuar. Dhe kemi kërkuar vëmendjen e tyre për t'i realizuar. Që nga vaditja tek kullimi megjithëse për kullimin kemi bërë ne vetë pjesën tonë.

Fatmir Prroni, Kryetar i fshatit Obot:

1. Ne kemi një banor të Darragjatit i cili ka marrë pronë dhe i ka zënë dhe uzurpuar duke na bërë problem në fshatin tonë.
2. Agrumet që prodhohen në Mal të Zi futen pa problem ndërkohë që tonat nuk mund të kalojnë përtej kufirit.
3. A është e mundur që të kemi një linjë transporti urban Muriqan – Shkodër me shpenzime normale pasi kjo do të sillte edhe zhvillim për zonën.

Kryetari i Bashkisë: - Sot kemi diskutuar për linjat e reja dhe do ta trajtojmë më tej këtë çështje, normalisht ka kosto dhe duhet vlerësuar duke qënë se ka fluks të madh sidomos gjatë verës.

Z Alfred Luleta, Drejtor Drejtorja e Shërbimeve Publike Investimeve dhe Infrastrukturës:

Kjo linjë funksionon si linjë rrethqytetëse e miratuar nga Këshilli Bashkiak, ideja e kthimit në transport urban ka lidhje me eficiencën ekonomike pasi autobusi ka nevojë për një numër të lartë pasagjerësh për të qënë ekonomike. Ne do të hapim vitin tjetër linja të reja dhe duhet studiuar

ekonomikisht kjo pjesë pasi edhe në qytet kemi hapur 5 linja dhe vetëm dy kanë pasur fitues sepse nuk marrin pjesë operatorët që të zhvillojnë këtë kontratë. Vitin tjetër do t'i hapim sërish.

Kryetari i Bashkisë : - Ne së bashku me Këshillin Bashkiak do ta marrim në shqyrtim duke subvencionuar biletën dhe duke e bërë më atraktiv dhënien e këtij shërbimi nga operatorët për shtim të linjave të tjera.

Gregor Pemaj, fshati Obot: - Kur është bërë rruga në Obot ka pasur kanal vaditës dhe kanali vaditës është i paprekur akoma, rruga është 1 metër e 20 sipër tokës dhe pengon kanalin duke krijuar edhe përmytje nga uji që nuk kalon nga rruga. Prandaj është e nevojshme që të bëhen dy ura për të kaluar uji.

Z. Arben Ceni, Administrator i Njësisë Ana Malit: - Ne do të pastrojmë kanalin kullues dhe pastaj do të bëjmë një urë që të jetë jo me tombino por e mirefilltë.

Xhevdet Kuti, banor: - Për lagjen Alimetaj edhe vjet kemi diskutuar, bashkia na ka premtuar dhe ska bërë asgjë. Kam kërkuar rrugë nuk është bërë, kemi prronin dhe akoma nuk n'a është riparuar. Nuk kemi gjatë gjithë verës ujë të pishëm dhe të paktën një tub ujit duhet të kemi për këtë zonë, rruga ka 32 vite që nuk është riparuar. Ne kemi nevojë për 1 km rrugë dhe kjo duhet të ketë prioritet sepse dalin të gjitha produktet bujqësore. Në tregun e shumicës nuk kemi mundësi për të tregtuar sepse n'a duhet një ambient për t'i tregtuar këto produkte. Edhe skavatori nuk vjen kurrë. Kemi problem edhe me qentë në qytet sepse n'a sulen kur lëvizim me motor.

Kryetari i Bashkisë: - Problematika e qenve është një tjetër problematikë që do të zgjidhet sepse po realizohet qendra e grumbullimit të qenve në fshatin Rrenc.

Bashkia nis nga Dukagjini dhe mbaron në Velipojë prandaj është me rëndësi të mirëkuptojmë jetesën në komunitet dhe rëndësinë e ndërhyrjes.

Xhevdet Kuti, banor i lagjes Alimetaj: - Shkolla Elbace ka një prrua të vogël që është pranë shkollës dhe ka nevojë për ndërhyrje me çakull ose tombina.

Kryetari i Bashkisë: - Këto takime nuk janë të kota janë me shumë rëndësi sepse kemi prioritet të degjojmë shqetësimet dhe t'i vendosim bashkarisht nevojat që keni. Nuk mendoj se nuk është bërë asgjë, kemi një listë me të gjitha projektet që janë bërë dhe jemi duke filluar lotin e katërt për këtë rrugë në lagjen Alimetaj dhe nuk mund të themi që nuk është bërë.

Zv. Kryetari i Bashkisë: - Zona e Anës së Malit ka pasur në vite investime, kam qenë administrator në Rrethina ku për numër banorësh dhe për sipërfaqe por edhe për nivel taksash të paguara duhet të theksojmë që Ana Malit ka marrë investime më shumë se sa njësitë e tjera.

Të ardhurat dhe shpenzimet në këtë zonë janë të gjitha në diferencë të madhe sepse duhet të jemi të drejtë edhe në këtë këndvështrim.

Duke qenë se zona nuk ka ujësjelles kemi problem vjeljen e taksave dhe nuk jemi vetëm ne përgjegjes për këtë pjesë. Duhet te jemi të gjithë koshient për këtë problem.

Bardhok Doda, Muriqan: - Taksat vilen dhe ne nuk kemi tapi të shtëpive tona.

Kryetari i Bashkisë: - Duhet të kuptojmë që as ne nuk i kemi të gjitha në dorë, pronësia jepet nga hipoteka dhe jo nga bashkia. Ne kemi dhene asistencë sa i përket përgatitjes së dosjeve për titujt e pronësisë por nuk është më në dorën tonë përveçse të komunikojmë dhe të shtojmë presionin ndaj agjencisë së kadastrës për këtë pjesë që pengon edhe subvencionet e për të cilën ne jemi koshient.

Ne si bashki e kemi kryer pjesën tonë ligjore por do vijojmë të llobojmë me institucionet për këtë pjesë në mënyrë që edhe ju si banorë të merrni zgjidhje.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak zj.Brisela Kadia: - Për problematikat që nuk janë pjesë e bashkisë mendoj të bëjmë një takim me prefekten për sa i përket problematikave që kane zonat e ndryshme, për drejtori të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe për t'i dhënë zgjidhje.

Osman Vataksi , Kryetar i fshatit Oblikë e Sipërme: - Kam mbjellë grurë dhe tokat i marr me qera nga te tjerët , kur bëj aplikimet apo letrat për naftë nuk arrij të marr tapi, dhe si pasojë nuk arrij të marr subvencion por duam te kemi nje pikë grumbullimi per sa i perket produkteve.

Kemi nevojë emergjente për ujësjellës, ujë të pijshëm që lidh edhe Alimetajn me Oblikën e sipërme.

Jozef Ndoci, Bashkia Shkodër specialist pranë drejtorisë së Mjedisit: - Për sa i përket Anës së Malit ne nuk kemi mundësi të ndërhyjmë sepse është pjesë e zonave të mbrojtura AKZM.

Osman Vataksi, Kryetar i fshatit Oblikë e Sipërme: - Rruga që është bërë krijon problem mes banorëve sepse duhet të ndahet nga bashkia kjo pjesë e bllokimi të kanaleve, sepse nuk na lejojnë të kalojmë apo pastrojmë kanalin. Për zjarrin, Taraboshi ka nevojë të ketë dy tre pika vrojtimi dhe kanë mjaftuar rastet e kaluara për një lajmërim për këtë pjesë për të mos marrë malin.

Z. Arben Ceni, Administrator i Njesisë Ana Malit: - Ështe me rëndësi që njerëzit të ndergjegjësohen për këtë pjesë dhe që gardhi të vendoset në tokë dhe jo në kanal ose në rrugë.

Z.Alban Sekja, Drejtor Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe AMTP-ve : - Kemi një urdhër që do të verifikohet kjo çështje për identifikim të këtyre rasteve të zënies së kanaleve etj.

Bardhok Doda, Muriqan: - Për sa i perket varrezave kemi një rrugë në Goricë dhe ka nevojë për ndërhyrje të paktën me cakull.

Z. Arben Ceni, Administrator i Njesisë Ana Malit: - Janë varre katolike të Samrishtit dhe të Dajçit dhe kemi kërkuar që të kemi ndërhyrje për mirëmbajtje rruge me cakull

IV. Ndrëimi dhe gjelbërimi.

Bardhok Doda, Muriqan: - Edhe fshati Muriqan ka vetëm 10 drita duhet të kemi shtesë të ndrëuesve.

Z. Arben Ceni, Administrator i Njësisë Ana Malit: - Ajo është rrugë nacionale dhe është e veshtirë që ne të ndërhyjmë në këtë pjesë për të vendosur ndrëues sepse nuk është pronësi e jona. Ne mund të vendosim në qendrat e fshatit por nuk është efciente sepse duhen vendosur nga ana e qeverisë për rrugën nacionale.

Z Alfred Luleta, Drejtor Drejtorja e Shërbimeve Publike Investimeve dhe Infrastrukturës:

Përsa i përket ndrëimit rrugor ne kemi një shtrirje të këtij shërbimi në të gjitha njësitë, kjo nuk arrihet për një ditë dhe në çdo investim ku janë bërë rrugë ka pasur edhe ndrëim. Kemi realizuar tenderin tani dhe do të ketë nje shtesë me 17 ndrëues.

Servet Kraja, Kryetar fshati Muriqan Xhakaj : - Nuk kemi ujë dhe kemi nevojë të kemi ndërhyrje, ka pasur perherë problem për këtë pjesë në fshat, Muriqani nuk ka asnjë rrugë të shtruar dhe ka nevojë për të pasur investime rrugësh dhe asnjë prej tyre nuk është e shtruar dhe janë rrugë 50– 100 metra dhe mund të realizohen me pak fonde.

Z. Arben Ceni Administrator i Njësisë Ana Malit: - Kemi edhe 3 segmente rrugë me nga 50 – 100 metra


- a) **Rruga në lagjen e re Oblikë.**
- b) **Rruga e Ambulancës.**
- c) **Rruga për qendrën shëndetësore.**

Kryetari i Bashkisë: - Duke ju falenderuar për opinionet dhe nevojat e paraqitura ju falenderoj sërisht dhe shpresojmë që të kemi mundësinë të realizojmë keto propozime të bera sot këtu nga ana juaj.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema




BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Nj.Administrative Ana e Malit

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1)	Bashkëbërës		Moshk		Merrifan	Taksi	
2	Ferid Paçi		Moshk		Oblik	Pa Pun	
3	Abaz	Sheja	M	52	Shkodër	Agjencia	B. Shkodër
4	Alfred Suleta		M	56	Shkodër	Jurist	B. Shkodër
5	Anita	Mitko	F	26	Shkodër	P. Sociale	B. Shkodër
6	Adrije	Telusha	F	60	Shkodër, Oblikë	Specialiste ME	NJA Ane Malit
7	Skender	Tajpi	M	62	Shkodër	Mësues	Shkola Oblikë
8	Orhan	Ploka	M	22	Oblikë	Oficer Kreditë	FED Invest
9	Faton	Ujeto	M	48	Oblikë	Mësues	H. Shkodër
10	Kujtim Loro						
11	Kujtim	Meksi	M	45	Oblikë	Puntor	
12	FERID RAMA		M	49	Oblikë	Puntor	
13	GERGJ	RAMA	M	43	OBOT	KRRIKA	

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Nj.Administrative Ana e Malit

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Enou	Metushi	M	25	SHKODËR	FARMACIST	F.S.O.F.SH
15	Admir	Seferi	M	50	Murgon	ferrier	Popull
16	Arben	Arnd	M	50	Oblike	Administrative	Shkollor
17	Vincenc	Gocaj	M	61	Obot	Imperier	Shkollor
18	GERGJ	Skaf	M	59	SHKODËR	Specialist	Poligoni Shkollor
19	Fatmir	Cuporon	M	60	Oblike	Kryetar fshat	Popull
20	Abdil Hoxha	Cuporon	M	60	Murgon	G.Z.I.M	Popull
21	Seferi Hoxha	Imaj	M	59	Murgon	Buyk	Popull
22	Adnan	Shzellani	M	51	Oblike	Arsimtar	Popull
23	Myrto Doka		M	58	Murgon	Buyk	Popull
24	Osman Hoxha		M	60	Oblike	Buyk	Popull
25	Thevdet Kurt	"	M	64	DRHAMSH	Kryetar fshat	Popull
26	Arif Daut	Myrta	M	60	Shkodër	specialist	Popull

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

